

URDHËR
Nr. 809, datë 9.10.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
 - a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
 - b) zogjve 24-orësh;
 - c) mishit të freskët;
 - d) materialit biologjik të shpendëve të pa shoqëruar me test diagnostik PCR, që vërteton mosprezencën e virusit;
 - e) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të *pseudopestit*, ku përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55⁰C në 2.5 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55⁰C në 2.3 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55⁰C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës të tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57⁰C në 50.4 orë;
 - dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:
 - 65⁰C në 39.8 sekonda;
 - 70⁰C në 3.6 sekonda;
 - 74⁰C në 0.5 sekonda;
 - 80⁰C në 0.03 sekonda;
 - f) nënprodukteve të shpendëve të patrajtura termikisht, nga shteti i Polonisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
1	Podlaskie	Mońki	Mońki*

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së *pseudopestit* të shpendëve për 12 muajt e fundit.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 1.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave

Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj